

Ilda Kazani (1979 –). Eksperte në fushën e tekstileve "smart", profesore e asociuar në departamentin e tekstit dhe modës (<http://www.upt-tekstilmoda.org>), të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës (<http://www.upt.al/>).Ka kryer shkollën tetëvjeçare (Fan Noli, 1993) dhe të mesme (Ismail Qemali, 1997) në Tiranë. Mbaroi studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës (2002), në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, dega inxhinieri tekstile. Me mbarimin e studimeve të larta u emërua pedagoge në departamentin e tekstit. Krahas mësimdhënies përfundoi një master të dytë (*part-time*) në *metalurgji dhe materiale*, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, ku pjesën kërkimore të diplomës e realizoi pranë departamentit të tekstileve, të Universitetit Gent, të Belgjikës (2008). Studimet e doktoraturës i filloi në vitin 2009, në saje të bursës së fituar nga “Projekti EMECW Basileus (Erasmus Mundus)”, në departamentin e tekstileve, të Universitetit Gent, të Belgjikës, ku ishte një anëtare aktive e grupit "Smart textile". Kërkimet shkencore i realizoi mbi objektin “Stampimi me shabllon i materialeve tekstile përcjellëse të elektricitetit”. Në vitin 2012 fitoi gradën “Doktor në inxhinieri tekstili”, si dhe diplomën e shkollës së doktoraturës në inxhinieri tekstili, pranë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Universiteti i Gentit në Belgjikë. Në vitin 2015 fitoi një bursë 3-mujore me anë të mobilitetit “CWO (Scientific Research Committee)”, akorduar nga Universiteti Gent i Belgjikës,për studime pasdoktorale, ku zhvilloi një kërkim mbi “Analizat termografike të lidhjeve përcjellëse të elektricitetit, të stampuara mbi tekstile”. Që prej vitit 2015 mori titullin "Profesore e Asociuar", pranë departamentit të tekstit dhe modës, të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ilda Kazani ka qenë pjesë e grupeve të shkrimeve të shumë projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, anëtare e bordit shkencor dhe organizues të *konferencave ndërkombëtare të tekstit* 6 (2014) dhe 7 (2016) (organizuar nga departamenti i tekstit dhe modës, Universiteti Politeknik i Tiranës), anëtare e bordit shkencor të konferencës ndërkombëtare të 6^{të} në “*Intelligent Textiles and Mass Customisation ITMC2017*” (organizuar nga pesë shtete: Belgjika, Kanadaja, Franca, Japonia dhe Moroku) si dhe anëtare e sekretariatit shkencor të konferencës ndërkombëtare “Inxhinieria dhe Siper marrja- ICEE-2017”(Organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike). Ilda Kazani është autore kryesore dhe bashkautore e 42 publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare dhe punime konferencash si dhe që nga 2014 është recensuese e revistave prestigjioze të tekstit (*Textile Research Journal* dhe *Journal of Industrial Textiles*). Ajo ka një H-indeks të publikimeve në *Web of Science*: 7; dhe në *Google Scholar*: 9, me 236 citime. (Qershor, 2017)